

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HËNË 11 PRILL 2022

Zonjë, mos mendoni se me censurë do të mund të mbuloni vjedhjet tuaja dhe cinizmin tuaj. Kjo është një përpjekje e njëllojtë si e atij mjeranit, që kërkon të mbulojë diellin me shoshë. Këtu po flitet për energjinë dhe krizën dhe unë dua t'i informoj shqiptarët se Shqipëria ka koston më të ulët në Europë dhe në botë të prodhimit të energjisë elektrike, e cila e prodhon me kosto 0,9 lekë. KESH-i , që e prodhon me këtë kosto, ia shet shpërndarësit me 2,2 lekë, ndërsa sot qeveria e makutrive dhe e vjedhjeve e shet 18 lekë.

Pra, kemi të bëjmë me një abuzim të jashtëzakonshëm. Janë prodhuar 9,8 teravat apo 9,8 miliardë energji elektrike dhe është vetëm 5,5 miliardë konsumi i tariforëve dhe, megjithatë, OSHEE-ja ka blerë 320 milionë euro energji elektrike me një çmim mesatar 205 euro në një kohë kur në bursën HUPX çmimi është 82 euro. Pra, janë vjedhje, vjedhje dhe vetëm vjedhje të mëdha. Shumë shpejt do ta shihni që do të jenë sa ato të inceneratorëve.

Pata këtu një debat me zonjën Xhaçka, unë nuk mund të akuzoj kurrë një njeri pa fakte, por po ju them këtu që neni 70, pika 3 e Kushtetutës, e ndalon deputetin të pasurohet nga pasuritë publike të shtetit apo të qeverisjes vendore. Në datën 2 mars të vitit 2022, bashkëshorti i zonjës Xhaçka, është shpallur investitor strategjik. Mua nuk më shkon për shtat t'i them e ke burrin strategjik, por faktikisht burri i deputetes shpallet investitor strategjik, sepse merr me leasing për 30 vjet me vendim qeverie dhe të Komitetit të Investimeve Strategjike.